



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:156726
Datë: 21.03.2025
Numri i dokumentit: 07024698

PML.nr.682/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar, Valdete Daka dhe Afrim Shala, anëtarë me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve: Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku dhe Burim Vokri për shkak të veprës penale në bashkëkryerje mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.2 dhe par.1 dhe me nenin 31 dhe 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe të dënuarve: Estrida Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokri dhe Valon Orllani, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje shpëlarja e parave nga neni 32 par.2, nënpar.2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëseve të të dënuarve; Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku, Burim Vokri, Xhemajl Arifi dhe Valon Orllani si dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të dënuarit Xhemajl Arifi, ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.60/2023 datë 17.11.2023 si dhe kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, APS.nr.5/2024 datë 22.4.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 6 shkurt 2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të pandehurve: Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku, Burim Vokri, Xhemajl Arifi dhe Valon Orllani si dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të pandehurit Xhemajl Arifi, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.60/2023 i datës 17.11.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, APS.nr.5/2024 i datës 22.4.2024, ashtu që bazuar në nenin 363 par.1.3 të KPP-së, të pandehurit Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku dhe Burim Vokri, me shënime personale si në shkresat e lëndës:

LIROHEN NGA AKUZA

Se: Nga data 02 shtator 2009 me zyre në tri lokacione të ndryshme në Prishtinë e gjer më 15 maj 2014 kur dhe janë arrestuar (përveç, Burim Vokri) pasi që e pandehura Estrida Bunjaku e ka regjistruar kompaninë e biznesit NSHN “...” (me 29 korrik 2009) me seli në P. përmes të cilës kompani në një rast dhe me 14 tetor 2009 ka regjistruar kompaninë e biznesit “...” SH.P.K., me nr. biznesi ... dhe me numër fiskal ..., rruga ... P., me veprimtari primare ndërtim i lartë dhe i ulët. Të cilat janë udhëhequr dhe kontrolluar nga e pandehura Estrida Bunjaku, duke vepruar në cilësinë e pronares, së bashku me të pandehurin Vigan Bunjaku në cilësinë e zyrtarit të lartë marketing dhe Burim Vokri në cilësinë zyrtarit të lartë të shitjes në kompaninë “...”, me qëllim që të sjellin dobi pasurore të kundërligjshëm për vete, me paraqitje të rreme dhe duke i fshehur faktet, i kanë shtytë personat tjerë ... të dëmtuar që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre, dhe atë duke i sjell në lajthim të dëmtuarit me paraqitje të ofertave të volitshme për shitjen e banesave. Fillimisht të dëmtuarve e pandehura Estrida u ka ofruar nënshkrimin e para kontratave me të gjitha të drejtat dhe obligimet me premtimin e ndërtimit dhe dorëzimin e banesave, në afatin e paraparë me para kontratë që ishte 12-18 muaj nga lidhja e para kontratës, përkundër vlerës së paguar në çmimin shumë të ulët dhe kushteve shumë të volitshme për pagesë. Paraprakisht të dëmtuarit kanë qenë të obliguar t'i pagujnë mjete financiare prej 5.000,00 euro vlera më e vogël e në lartësi të ndryshme dhe pastaj dy të pandehurit tjerë Vigan Bunjaku dhe Burim Vokri në bashkëpunim me të akuzuarën Estrida edhe pasi kishin njohuri se banesat nuk do të ndërtoheshin dhe nuk po ndërtoheshin i shoqërojnë të dëmtuarit duke i dërguar për t'ua treguar vendin ku

kinse do të ndërtohej apo edhe duke i shoqëruar qoftë kur është bërë pagesa në bankë. Të dëmtuarit të hollat i kanë paguar në xhirollogari të Kompanisë “...” dhe në disa raste edhe xhirollogarinë personale të të pandehurës Estrida Bunjaku, e që të gjitha të hollat tërhiqen brenda ditës. Ndërtimi nuk është bërë dhe të dëmtuarit nuk kanë marrë banesat e parapara në para kontratë dhe as nuk u janë kthyer të hollat (me përjashtim të disa të dëmtuarve). Ashtu që të njëjtit kanë përfituruar mjete financiare në mënyrë të kundërligjshme me vlerë prej rreth 1.872,719 euro.

Nga të dëmtuarit që paguan për blerje të banesave janë: A. D., A. S., A.I. dhe V. I., A. V., A. G., A. M. me S. M., A. me M. B., A. G., A.H., A. M., A. H., A. B., A. K., A. K. me V. M. K., A. A., A. dhe A. Ç., A. S., A. J., A. K., A. M.-K., A. J., A. Q., A. M., A. S., B. S., B. G., B. P., B. S., B. H., B. Sh., B.H. dhe R. H., B. K., B. M. dhe F. K. M., B. P., B.B., D. B., D. L., D. O., A. B. dhe D. B., E. V., E.U., E. R., E. P., E. K., E. Xh. dhe N.Xh., E. Gj., E. S., F. dhe I. K., F.Sh., F. Sh., F. Z., F. B. dhe S. B., F. G., F. D., F. H., F. H., F. Zh., F. E., F. E., F. H., G. dhe V. H., G. M., G. dhe M. N., G. H., H. K., H. K., H. L., H.D., H. Th., I. K. dhe E. B., I. G. dhe L.K. – G., I. S., I. H., I. B. dhe L. A., I. H., I. R., J. D. dhe D. D., J. P., L. P., L. D., L. P. dhe A. P., L. B., L. dhe A. A., L. E., L. Sh., L. M., M. M., M. K., M. S., M.S.E., M. C., M. Sh. E. dhe L. E., M. U., M. G., M. H., M. K. dhe I. N., M. B., M. S., M. B., N. LI., N. M., N. S., N. P., N. P., N. B., N. P., N. L., P. L., Q. K., Q. B., J. B. dhe R. B., Q. R., R. K., R. S., R. M., N. D., R. Z., Rr. B., S. M., S. Sh., S. Z., S. B., S. H., S. S., S. Sh., S. M., S. K., S. M., Sh. S., Sh. K., Sh. K., Sh. G., Sh. Sh., Sh. P. H., Sh. A., Sh. K., S. B., S.Xh., S. S., S.F. dhe E. F., T. P., T. dhe Xh. B., V. D., V. S., V. L., V. B., V. M., Xh. S., Xh. K., Xh. B., Xh. Xh., Z. J., Z. P., Z. H.,

- Me çka kishin për të kryer veprën penale “mashtrimi” nga neni 335 par.5 lidhur me par.2 dhe par.1 e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së,

Të pandehurit: Estrida Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokri dhe Valon Orlani, me shënime personale si në shkresa të lëndës, në kuptim të nenit 363 par.1, nënpar.1 1.3 të KPP-së;

LIROHEN NGA AKUZA

2. Se: në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si nën pikën 1 të këtij dispozitivi, pasi që janë përfituruar mjete financiare në vlerë rreth 1.872,719 euro, e duke ditur se

mjetet financiare të cilat kanë buruar nga aktiviteti kriminal i të pandehurve si nën pikën 1 të dispozitivit duke tentuar t'i konvertinin, transferonin me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë. Në bashkëkryerje kanë bërë shpëlarjen e parave, ashtu që i pandehuri Xhemajl Arifi, fillimisht me datën ... ka vepruar në atë mënyrë që duke i mundësuar të pandehurës Estrida Bunjaku si pronare e firmës "...", fshehjen e gjurmëve, të pasurisë - Objektivit që kishte filluar ta ndërtoj me mjete financiar të përfituara me aktivitet kriminal-mashtrim, i njëjti nga e pandehura Estrida Bunjaku ka pranuar autorizimin e vërtetuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë, i datës 01.08.2011, me të cilin e autorizon të pandehurin Xhemajl Arifi që në mënyrë gjenerale dhe pa kufizim të përfaqësoj në emër personal dhe në emër të firmës "...", me pronarët e tokave sipas kontratave për patundshmëritë lidhur me ndërtimin e banesave. Pasi që Estrida ka pas obligim ndaj pronarëve të truallit. Pastaj i pandehuri Xhemajl Arifi me datën ..., nga e pandehura Estrida Bunjaku, pranon një deklaratë të vërtetuar në Gjykatën Komunale Prishtinë - Dega në Graçanicë, Vr.nr.6400/2011 me të cilën vërteton se heq dorë nga implementimi i kontratës për ndërtimin e banesave dhe lokaleve afariste të legalizuara pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë, Vr.nr.3093 datë 05.09.2009, Vr.nr.3180/2009 datë 07.05.2009, Vr.nr.3769/2009, datë 27.05.2009, dorëheqjen e bënë në favor të të pandehurit Xhemajl Arifi, ndërsa obligimet ndaj blerësve të banesave dhe punë kryesve mbasin obligim i të pandehurës Estrida Bunjaku, dhe në fund që të humbet gjurmët edhe me shumë i pandehuri Xhemajl Arifi me datë 16 janar 2012 nënshkruan marrëveshje për re investime të banesave dhe lokaleve afariste të cekura si më lartë.

I pandehuri Burim Vokri në periudhën kohore të përshkruar si nën pikën 1 të këtij dispozitivi duke ditur se Estrida Bunjaku dhe vet i akuzuari Burim mjetet financiare i kanë përfituar me aktivitete kriminale me qëllim që ato mjete financiare t'i konvertoj transferoi me qëllim të fshehjes, apo maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit të mjeteve financiare nga e pandehura Estrida Bunjaku një automjet - ..., një dhomë fjetje, shpenzimet për dasmë, shpenzimet për pushime verore dhe shpenzime tjera.

I pandehuri Valon Orllani në periudhën kohore të përshkruar si nën pikën 1 të këtij dispozitivi duke ditur se e pandehura Estrida Bunjaku mjetet financiare i ka përfituar me aktivitet kriminal me qëllim që ato mjete financiare t'i fshehë, maskoj me qëllime të ndihmës nga e pandehura Estrida Bunjaku me data të ndryshme gjatë viteve 2009,

2010 dhe 2011, përmes xhirollogarisë personale pranë Western Unkon në D. ka pranuar mjete financiare në vlerë prej 16.000,00 euro, pastaj me datën 4 shtator 2010 në D. ka pranuar shumën e të hollave, në vlerë prej 14.600,00 euro, nga A.B., në emër të pagesës së borxhit për blerjen e një banese po ashtu nga Estrida me datën 29.01.2010 kishte pranuar një veturë xhip ..., në vlerë prej 35.300,00 euro, si dhe i ka blerë një truall në fshatin Ll., komuna e P., Valon Orllanit në sipërfaqe prej ...ari (...m2),

- me çka në bashkëkryerje kishin për të kryer veprën penale shpëlarja e parave nga neni 32 par.2 pika 2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit lidhur me nenin 31 dhe lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

II. Të dëmtuarit e lartcekur si dhe të dëmtuarit: V. I., I. I., S. B., N. B., V. dhe R. H., S. B., F. M., F. Gj., H. K., H. H. dhe D. H., për realizimin e kërkesave pronësore-juridike, udhëzohen në kontest civil.

III. Trualli i konfiskuar nga i pandehuri Valon Orllani, i cili gjendet në fshatin Ll., komuna e P. në sipërfaqe prej ... ari (... m2), sipas certifikatës së pronësisë P-..., i kthehet të njëjtit.

IV. Shpenzimet e procedurës penale për të gjithë të pandehurit bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.60/2023 të datës 17.11.2023, të pandehurit: Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku dhe Burim Vokrri, janë shpallur fajtorë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.2 e par.1 e lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së, dhe konform nenit 80 të KPRK-së, si dhe të pandehurit: Estrida Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokrri dhe Valon Orllani janë shpallur fajtor për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale shpëlarja e parave nga neni 32 par.2, nënpar.2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së.

Të pandehurës Estrida Bunjaku, i është shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vite, si dhe me gjobë në shumë prej 120.000 (njëqindnjëzet mijë) euro. Në dënimin me burg i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 15.05.2014 deri më datë 15.05.2015, nga data 15.06.2022 e deri më datë 16.05.2023, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 16.05.2023 e deri më datë 19.10.2023. Dënimi me burg do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse e pandehura dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, dënimi do t'i zëvendësohet me dënim me burg, duke ia llogaritur për 1 (një) ditë burg 20 (njëzetë) euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkalon 3 (tri) vite. E pandehura është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 500 (pesëqind) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 200 (dyqind) euro si dhe në emër të fondit për kompensim të viktimave të krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro.

I pandehuri Burim Vokri, me të njëjtin aktgjykim pasi që është shpallur fajtor për veprat e cekura si më lartë, konform nenit 80 të KPRK-së, i është shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si dhe dënim me gjobë në shumë prej 60.000 (gjashtëdhjetëmijë) euro. Në këtë dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 15.06.2022 e deri më datë 16.05.2023 si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 16.05.2023 e deri më datë 19.10.2023. Dënimi me burg do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, dënimi do t'i zëvendësohet me dënim me burg, duke ia llogaritur për një ditë burg 20 euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkalon 3 (tri) vite. I pandehuri është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 500 (pesëqind) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 200 (dyqind) euro si dhe në emër të Fondit për Kompensim të Viktimave të Krimit shumën prej 50 euro.

Të pandehurit Vigan Bunjaku, pasi që është shpallur fajtor i është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 10.000

(dhjetëmijë) euro, ndërsa në dënimin me burgim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 15.06.2022 deri më datë 16.05.2023 si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 15.05.2014 deri më datë 14.10.2014 si dhe nga data 16.05.2023 deri më datë 19.10.2023. Dënimi me burg do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, dënimi do t'i zëvendësohet me dënim me burg, duke ia llogaritur për 1 (një) një ditë burg 20 (njëzetë) euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkalon 3 (tri) vite. I pandehuri është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 500 (pesëqind) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 200 (dyqind) euro si dhe në emër të fondit për kompensim të viktimave të krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro.

Të pandehurit Xhemajl Arifi, i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 50.000 (pesëdhjetëmijë) euro, ku dënimi me burg do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muaj, nga data e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg, duke ia llogaritur 1 (një) një ditë për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkalojë 3 (tri) vite. I pandehuri është obliguar që të paguaj në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 200 (dyqind) euro, në emër të paushallit gjyqësor 120 (njëqindenjëzet) euro, si dhe në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit, shumën prej 50 (peëdhjetë) euro.

Të pandehurit Valon Orllani për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 50.000 (pesëdhjetëmijë) euro, ku dënimi me burg do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muaj, nga data e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj brenda afatit të caktuar, gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg, duke ia llogaritur 1 (një) ditë për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës, por dënimi nuk mund të tejkalojë 3 (tri) vite. I pandehuri është obliguar që të paguaj në emër të shpenzimeve të procedurës penale

shumën prej 200 (dyqind) euro, në emër të paushallit gjyqësor 120 (njëqindnjëzet) euro, si dhe në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit, shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro. Nga i pandehuri Valon Orllani është konfiskuar trualli në fshatin Ll., komuna e P. në sipërfaqe prej... ari (... m2) sipas certifikatës së pronësisë P-... .

Të pandehurit: Estrida Bunjaku, Burim Vokrri, Vigan Bunjaku, Xhemajl Arifi dhe Valon Orllani, janë obliguar që në mënyrë solidare dhe nën kërcënim të përbarimit me dhunë të paguajnë dëmshpërblim në lartësinë e pagesave të bëra të dëmtuarve dhe atë:

1. A. D.shumën prej 10.000 (dhjetëmijë) euro,
2. A. G.shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
3. A.V. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
4. A. M. shumën prej 10.000 (dhjetëmijë) euro,
5. A. G. shumën prej 2.500 (dymijepesëqind) euro,
6. A. H.shumën prej 10,300 (dhjetëmijetreqind) euro,
7. A. M. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
8. A. H. shumën prej 11,700 (njëmbëdhjetëmijeshtatëqind) euro,
9. A. B. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
10. A. K. shumën prej 10,600 (dhjetëmijegjashtëqind) euro,
11. A. K. shumën prej ...11,640 (njëmbëdhjetëmijegjashtëqindedyzet) euro,
12. A. S. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
13. A. M.-K. shumën prej10,000 (dhjetëmijë) euro,
14. A. Q.shumën prej 17,070 (shtatëmbëdhjetëmijeshtatëdhjetë) euro,
15. A. M. shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
16. B. S. shumën prej15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
17. B. G. shumën prej10,000 (dhjetëmijë) euro,
18. B. P. shumën prej16,100 (gjashtëmbëdhjetëmijenjëqind) euro,
19. B. S. shumën prej12,000 (dymbëdhjetëmijë) euro,
20. B. Sh. shumën prej12,600 (dymbëdhjetëmijegjashtëqind) euro,
21. B. H. shumën prej 30,000 (tridhjetëmijë) euro,
22. B. K. shumën prej ...31,950 (tridhjetenjëmijenëntëqindepesëdhjetë) euro,
- 23.D. B. shumën prej 10,00 (dhjetëmijë) euro,
- 24.D2 B. shumën prej15 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,

- 25.D. L. shumën prej10, 000 (dhjetëmijë) euro,
26.D. O. shumën prej 21,300 (njëzetenjëmijetreqind) euro,
27.E. V. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
28.E. U. shumën prej 10,340 (dhjetëmijetreqindekatër dhjetë) euro,
29.E. K. shumën prej 3,900 (tremijenëntëqind) euro,
30.E. Xh. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
31.E. S. shumën prej 26,000 (njëzetegjashtëmijë) euro,
32.E. F. shumën prej.....11,316 (njëmbëdhjetëmijetreqindegjashtëmbëdhjetë) euro,
33.F. K. shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
34.F. Sh. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
35.F. Z. shumën prej 14,500 (katërmbëdhjetëmijepesëqind) euro,
36.F. G. shumën prej10,00 (dhjetëmijë) euro,
37.F. D. shumën prej10,180 (dhjetëmijenjëqindetëtdhjetë) euro,
38.F. H. shumën prej 10.822 (dhjetëmijetëqindenjëzetedy) euro,
39.F. H. shumën prej 24,000 (njëzetekatërmijë) euro,
40.F. Zh. shumën prej 6,000 (gjashtëmijë) euro,
41.F. E. shumën prej 5,000 (pesëmijë) euro,
42.F. E. shumën prej 5,171 (pesëmijenjëqindeshatëdhjetenjë) euro,
43.G. N. shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
44.G. M. shumën prej10,000 (dhjetëmijë) euro,
45.G. H. shumën prej 10, 000 (dhjetëmijë) euro,
46.H. K. shumën prej 12,000 (dymbëdhjetëmijë) euro,
47.H. D. shumën prej13,000 (trembëdhjetëmijë) euro,
48.H. Th. shumën prej...12,550 (dymbëdhjetëmijepesëqindepesëdhjetë) euro,
49.I. K. shumën prej10,000 (dhjetëmijë) euro,
50.I. G. shumën prej 5,000 (pesëmijë) euro,
51.I. K. shumën prej 5,000 (pesëmijë) euro,
52.I. H. shumën prej 11,500 (njëmbëdhjetëmijekatërqind) euro,
53.I. dhe L. B. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
54.I. H. shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
55.I. R. shumën prej10,000 (dhjetëmijë) euro,
56.K. T. shumën prej10,412 (dhjetëmijekatërqindedymbëdhjetë) euro,
57.J. D. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
58.J. P. shumën prej10,400 (dhjetëmijekatërqind) euro,

- 59.L. P. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
60.L. D. shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
61.L. A. shumën prej 6,000 (gjashtëmijë) euro,
62.L. Sh. shumën prej 46,150 (katër dhjetë e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë) euro,
63.M. K. shumën prej16,34.60 (gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e katër euro e gjashtëdhjetë cent),
64.M. B. shumën prej12,400 (dymbëdhjetëmijë e katërqind) euro,
65.M. S. shumën prej 8,000 (tetëmijë) euro,
66.M. C. dhe I. A. shumën prej10,000 (dhjetëmijë) euro,
67.M. S. E. shumën prej 14,000 (katërmëdhjetëmijë) euro,
68.M. G. shumën prej11,771 (njëmbëdhjetëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një) euro,
69.M. K. shumën prej6,440 (gjashtëmijë e katërqind e katër dhjetë) euro,
70.M. H. shumën prej 7,500 (shtatëmijepesëqind) euro,
71.M. B. shumën prej 20,000 (njëzetmijë) euro,
72.Naim Llugaliu shumën prej 30,000 (tridhjetëmijë) euro,
73.N. M. shumën prej 5,840 (pesëmijetetëqind e katër dhjetë) euro,
74.N. S. shumën prej 31,000 (tridhjetenjëmijë) euro,
75.N. P. shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro,
76.N. D. shumën prej 20,000 (njëzetmijë) euro,
77.N. Ll. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
78.P. L.shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
79.Q. K. shumën prej 18,000 (tetëmbëdhjetëmijë) euro,
80.Q., J. dhe R. Berisha shumën prej34,000 (tridhjetë e katërt mijë) euro,
81.Q. R. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
82.R. K. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
83.R. M. shumën prej..... 25,000 (njëzetepesëmijë) euro,
84.R. S. shumën prej..... 12,000 (dymbëdhjetëmijë) euro,
85.R. B. shumën prej 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
86.K. G. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
87.S. Sh. shumën prej..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
88.S. Z. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
89.S. H. shumën prej 43,000 (katër dhjetë e tremijë) euro,

90. S. S. shumën prej 2,000 (dymijë) euro,
91. S. Sh. shumën prej..... 7,000 (shtatëmijë) euro,
92. S. M. shumën prej.....10.000 (dhjetëmijë) euro,
93. S. M. shumën prej10,000 (dhjetëmijë) euro,
94. Sh. S. shumën prej11,200 (njëmbëdhjetë mijë) euro,
95. Sh. K. shumën prej12,800 (dymbëdhjetëmijë e tetëqind) euro,
96. Sh. Sh. shumën prej25,000 (njëzetë e pesë mijë) euro,
97. Sh. P. shumën prej12,200 (dymbëdhjetëmijë e dyqind) euro,
98. Sh. K. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
99. Sh. A. shumën prej..... 8,000 (tetëmijë) euro,
100. S. B. shumën prej11,500 (njëmbëdhjetëmijëpesëqind) euro,
101. E. dhe S. F. shumën prej11,440 (njëmbëdhjetëmijë e katërqind e katër dhjetë) euro,
102. S. Xh. shumën prej 8.000 (tetëmijë) euro,
103. S. S. shumën prej10,000 (dhjetëmijë) euro,
104. T. P. shumën prej.....17,500 (shtatëmbëdhjetëmijë e pesëqind) euro,
105. T. P. shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) euro,
106. V. K. shumën prej14,500 (katërmëdhjetëmijë e pesëqind) euro,
107. V. dhe A. I. shumën prej18,300 (tetëmbëdhjetëmijë e treqind) euro,
108. V. D. shumën prej 11,000 (njëmbëdhjetë mijë) euro,
109. V. S. shumën prej..... 10,000 (dhjetëmijë) euro,
110. V. L. shumën prej 10.000 (dhjetëmijë) euro,
111. V. M. shumën prej 10,600 (dhjetëmijë e gjashtëqind) euro,
112. Xh. S. shumën prej 17,292 (shtatëmbëdhjetëmijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy) euro,
113. Xh. B. shumën prej 17,376 (shtatëmbëdhjetëmijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) euro,
114. Xh. K. shumën prej 32,500 (tridhjetedymijë e pesëqind) euro,
115. Xh. Xh. shumën prej5,000 (pesëmijë) euro,
116. Z. P. shumën prej6,500 (gjashtëmijë e pesëqind) euro,
117. Z. F. J. shumën prej15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro,
118. Z. H. shumën prej8.000 (tetëmijë) euro.

Përtej shumës së gjykuar palët e dëmtuara të cekura më lartë, janë udhëzuar në kontest civil.

Të dëmtuarit: V. I., I. I., S. B., N. B., V. dhe R. H., S. B., F. M., F. Gj., H. K., H. H. dhe D. H., të paraqitur në aktakuzë si të dëmtuar, janë udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.5/2024 e datës 22.4.2024, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e ushtruara nga mbrojtësit e të pandehurve dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të pandehurës Estrida Bunjaku, av. Liridon Tafa, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ose të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, po ashtu është propozuar që në bazë të nenit 434 par.4 të KPP-së, të shtyhet ekzekutimi i sanksionit penal deri në marrjen e vendimit sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, apo të caktojë shtyrjen përkatësisht ndërprerjen e ekzekutimit të sanksionit penal;

- mbrojtësi i të pandehurit Vigan Bunjaku, av. Murat Demolli, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

- mbrojtësi i të pandehurit Burim Vokri, av. Fanol R.Krasniqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet apo të ndryshohen dhe i pandehuri në mungesë të provave të lirohet nga akuza;

- i pandehuri Xhemajl Arifi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e

kundërshtuara të ndryshohen dhe i pandehuri të lirohet nga akuza ose të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;

- mbrojtësi i të pandehurit Xhemajl Arifi, av. Naim Q.Rudari, për shkak të shkeljes së Ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuar atë anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim apo të ndryshohen dhe i pandehuri të lirohet nga akuza në mungesë të provave, si dhe;

- mbrojtësi i të pandehurit Valon Orllani, av. Ramiz Krasniqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Prokuroria e Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtresat KMLP.II.nr.394/2024 të datës 12.11.2024 dhe 2.12.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruara nga mbrojtësit e të pandehurve; Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokri e Valon Orllani si dhe kërkesa e të pandehurit Xhemajl Arifi, të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, janë të bazuara.

a). *Pretendimet nga kërkesat,*

Në kërkesë, mbrojtësi i të pandehurës Estrida Bunjaku, av. Liridon Tafa, nga P., pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat shkelje kanë të bëjnë me shkelje nga neni 384 par.2, nënpar.2.7 të KPP-së, pasi që aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 të KPP-së dhe në kundërshtim me par.7 të dispozitës së cekur. Kjo nga

fakti se në aktgjykimin e saj, gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë mbi faktet vendimtare dhe të cilat përbëjnë elementet e veprave penale për të cilat është shpallur fajtores. Po ashtu, gjykata nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës së shkallës së dytë në rigjykim. Më tutje, mbrojtësi i referohet udhëzimeve nga Gjykata e Apelit e Kosovës, e cila në aktgjykim me të cilin është anuluar aktgjykimi i shkallës së parë, ka kërkuar që të vërtetohet fakti se a ka pasur pengesa reale ndërtimi ku për pasojë është shpërfaqur një gyp dhe për këtë është dashur të kërkohet nga Ujësjiellësi Rajonal i Prishtinës. Gjykata e shkallës së parë, pasi që ka marrë përgjigjen në të cilën është konstatuar se pronarët e tokave (pa investitorin) kanë aplikuar për kushte teknike me datë 22.03.2010 dhe me datë 07.04.2010 është lëshuar dokumenti për kushtet teknike të pjeshme dhe është konstatuar që mund të ndërtohen vetëm 2 objekte, ndërsa 2 objekte tjera jo, për arsye se gypi që ka qenë nuk lejon të ndërtohen edhe dy të tjera. Fakt ky që gjykata fare nuk e konsideroi e sidomos faktin se pronarët e tokave duke anashkaluar investitorin bëjnë vet kërkesë për këtë gyp. Ndërsa gjykata e shkallës së dytë gjithashtu e anashkalon këtë fakt.

Sa i përket shkeljes së ligjit penal, mbrojtësi konsideron se ka pasur shkelje duke aplikuar gabimisht ligjin në kohën kur është supozuar se është kryer vepra penale dhe duke konstatuar "siç rezulton nga të cekurat më lartë periudha kohore e kryerjes së veprës penale përfshinë edhe kohën kur kishte ndryshime ligjore, pra, periudhën nga 02.09.2009 e deri më 31.12.2012 kur ishte në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës i vitit 2013 dhe periudha 01.01.2013 e gjer më datën 15.5.2014 kur ishte në fuqi Kodi Penal nr.04/L-082 të cilat kode e sanksionojnë veprën penale të mashtrimit, edhe pse Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës i vitit 2004 ishte më i favorshëm sa i përket lartësisë së dënimit me burgim, ku është përcaktuar maksimumi prej 5 vite". Gjykata ka bërë rikualifikimin e veprës penale konform kodit penal që ishte në fuqi kur ishin ndërmarrë veprimet e fundit e duke u bazuar në Udhëzuesin e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, lidhur me nenin 7 i datës 30 prill 2017, ndërsa gjykata e shkallës së dytë jep arsyetim se "aktakuza është ngritur sipas Kodit Penal që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, megjithatë të akuzuarit janë shpallur fajtorë për veprën penale mashtrimi të kryer në vazhdim pasi që veprimet inkriminuese përfshinë edhe periudhën kohore pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal i cili ka hyrë në fuqi nga data 1 janar 2013, pasi që njëjtit kanë vazhduar t'i mbajnë në lajthitje të dëmtuarit për ndërtimin e banesave. Lidhur me këtë ekzistojnë para kontrata edhe gjatë vitit 2013, siç është rasti

i S. F. B., me të cilën e akuzuara Estrida Bunjaku, e cila ka lidhur para kontratë mbi shitblerjen me datën 15.03.2013 si dhe marrëveshja e datës 25 janar 2013 e lidhur me S. M., për pagimin e qerasë, pra ka vazhduar aktiviteti inkriminues dhe si i tillë duhet të trajtohet në tërësi, andaj në këto situata meqë kemi të bëjmë me një vepër penale, zbatohet ligji i cili ka qenë në fuqi në momentin e ndërmarrjes së veprimit të fundit, pavarësisht që shumica e veprimeve janë kryer në kohën kur ka qenë në fuqi Kodi Penal i datës 6 prill 2004. Kolegji i gjykatës së apelit rikujton se vepra penale mashtrimi nga neni 355 par.5 të KPRK-së është e dënueshme prej 3-5 vjet burgim, ndërsa në kuptim të nenit 106 par.3 të KPRK-së, parashkrimi i ndjekjes penale përcakton periudhën kohore prej 10 vjet nga kryerja e veprës penale e dënueshme me më shumë se 5 vjet burgim, ndërsa dyfishi i kohës së parashkrimit të ndjekjes penale në kuptim të nenit 107 par.8 të KPRK-së është 20 vite, andaj, edhe nuk është arritur edhe afati i parashkrimit”. Gjykata e Apelit fare nuk e ka marrë parasysh nenin 2 të Kodit Penal të vitit 2013, ku zbatimi i ligjit më të favorshëm për të pandehurin do të duhej të zbatohet edhe nëse ka qenë vepër penale e vazhduar në të dy periudhat kohore, ku pretendohet se janë kryer veprat penale, andaj mbrojtja konsideron që ka ardhur deri te parashkrimi i veprës penale.

Mbrojtësi i të pandehurit Vigan Bunjaku, av. Murat Demolli, nga P., në kërkesë pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënpar.1.10 dhe par.2, nënpar.2.6 dhe 2.7 të KPP-së, e të cilat shkelje qëndrojnë në faktin se dispozitivi i aktgjyimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe në të nuk janë paraqitur arsye lidhur me faktet vendimtare dhe se ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetim e lidhur me përmbajtjen e shkresave të çështjes, ku si rrjedhojë aktgjykimi i tillë nuk është përpiluar konform dispozitave të nenit 369 të KPP-së.

Këto paqartësi dhe kundërthënie qëndrojnë se me veprimet e përbashkëta (neni 31 i KPRK-së) të akuzuarve prej nga kjo rezulton me elementet qenësore të veprës penale të mashtrimit për çka edhe janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar të akuzuarit. Edhe pse, nga dispozitivi i aktgjyimit nuk rezulton se si janë marrë vesh të akuzuarit dhe cila ishte detyra apo kontributi i të dënuarit Vigan Bunjaku në këtë vepër penale e për të cilat pretendime Gjykata e Apelit fare nuk ka dhënë arsye. Mbrojtja në kërkesë

thekson se si është e mundur që një punëtor i cili punon në kompani dhe kryen punët e veta të përcaktuara në atë vend pune edhe pse i njëjti nuk ka nënshkruar asnjë parakontratë e as që ka pranuar mjete financiare, përveç pagës mujore.

Sa i përket shkeljes së ligjit penal, mbrojtja konsideron se pasi që gjendja faktike është vërtetuar gabimisht ka edhe shkelje të drejtës materiale me rastin se shqiptimit të dënimit e sidomos pasi që i njëjti është obliguar me të dënuarit tjerë që në mënyrë solidare të paguaj dëmshpërblimin në lartësinë e pagesave të bëra të dëmtuarve.

Mbrojtësi i të pandehurit Burim Vokri, av. Fanol R. Krasniqi nga P., në kërkesë pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënpar.1.9, 1.10 dhe par.2, nënpar.2.1, 2.4, 2.6 dhe 2.7 e lidhur me nenet 359, 364, 369 par.4 dhe me nenin 385 par.1.2, 1,3 dhe 1.4 të KPP-së, e të cilat shkelje konsistojnë në faktin se aktgjykimet janë të pakuptueshme, kundërthënëse në brendinë e tyre dhe në to nuk janë paraqitur arsye lidhur me faktet vendimtare, ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimet e tyre lidhur me përmbajtjen e shkresave të çështjes. Kështu, aktgjykimet janë marrë me shkelje të parimit “reformatio in peius” nga neni 395 të KPP-së, ngase përveç që është tejkalluar aktakuza nga gjykata e shkallës së parë, edhe Gjykata e Apelit në mungesë të ankesës së prokurorisë, tejkalon edhe aktgjykimin të cilin e vërteton në arsyetim edhe pse gjykata e shkallës së parë vërteton se prova e datës 15.03.2013 është jo relevante për periudhën që përfshihet në aktakuzë, Gjykata e Apelit, konstaton se pikërisht kjo provë është relevante për të mbështetur rikualifikimin e veprës penale, me qëllim për të zbatuar Kodin Penal të vitit 2012 dhe për të mbështetur vazhdimin e kryer të veprës penale edhe për këtë periudhë.

Sa i përket veprës penale të shpëlarjes së parave, gjykatat janë referuar dispozitave nga neni 32 të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, të cilat nuk e rregullojnë sanksionimin penal, por ka vetëm përkufizime, pra, gjykata fare nuk ka dhënë arsyetim lidhur me rrethanat për shqiptimin e dënimit për këtë vepër. Edhe fakti se gjykata me rikualifikimin e veprave penale “ex officio” e me të vetmin qëllim për t’iu shmangur parashkrimit. Më tutje, mbrojtësi konsideron se dispozitivët e aktgjykimeve janë të paqartë e që pasqyrohet nga fakti se nuk dihet se nga cilat prova materiale ka buruar, që i akuzuari Burim Vokri ka shtyrë persona për të blerë banesa duke e ditur se nuk do të ndërtoheshin, ngase gjykatat nuk japin fare

arsyetim për këtë fakt. Sa i përket shkeljes së ligjit penal, mbrojtja konsideron se aktgjykimet janë në kundërshtim me nenin 2 dhe 3 të KPRK-së, duke mos zbatuar ligjin në fuqi dhe ligjin më të favorshëm për të dënuarit (arsye pothuajse identike si në kërkesën e mbrojtësit të pandehurës Estrida Bunjaku).

Po ashtu, mbrojtja konsideron se në veprimet e të pandehurit Burim Vokrri, sa i përket veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.5 të KPRK-së, nuk është arsyetuar se cilat janë veprimet të cilat përbëjnë elemente të kësaj vepre penale e sidomos paraqitja e rreme e fakteve apo fshehja e tyre.

Sa i përket vendimit për veprën penale shpëlarja e parave të dy gjykatat janë kundërthënëse me vetveten ngase konstatojnë se Burim Vokrri asnjëherë nuk ka pranuar nga Estrida Bunjaku banesë, lokal apo garazhe ku i njëjti në këtë rast edhe është i dëmtuar sepse i ka dhënë 7000 € hua të pandehurës Estrida Bunjaku dhe për këtë ka marrë si dëmshpërblim një veturë të tipit "...", ndërsa gjykatat si shpëlarje të parave konsiderojnë faktin se i njëjti me rastin e martesës ka pranuar një dhuratë dhomë fjetjeje dhe shpenzimet e dasmës e që është në kundërshtim me format e shpëlarjes së parave. Mbrojtja konsideron se gjykata duke zbatuar dispozitat e Kodit Penal ka rënë ndesh me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore dhe Ligjit për Ndërtimin, të cilat rregullojnë pikërisht veprimet të cilat përshkruhen në vendimet e goditura dhe bazuar në këto dispozita, veprimet e Burim Vokrri, nuk përbëjnë figurën e veprës penale. Kjo ngase është e qartë se të gjitha veprimet janë në raport juridiko-civil ngase për ndërmjetësim, urdhërdhënësi detyrohet t'i paguajë shpërblim të caktuar nëse kjo kontratë do të lidhet dhe pikërisht këtë situatë e përshkruajnë vendimet e goditura në raport me të dënuarin edhe pse nuk përshkruhet se i njëjti ka qenë i suksesshëm në gjetjen e klientëve. Pavarësisht nga këto gjykata është dashur të arsyetojë elementin e dashjes dhe dijenisë për mashtrim posaçërisht të lidhjes së kontratës së punës në mes të dënuarit dhe kompanisë apo themelimin e kësaj të fundit për qëllim mashtrimi.

Mbrojtësi i të pandehurit Xhemajl Arifi, av. Naim Rudari nga P., pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje konsistojnë në faktin se në fazën e rigjyimit, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nuk kemi të bëjmë me veprën penale "krimi i organizuar" por ka gjetur

se është kryer vepra penale e mashtrimit nga neni 335 par.5 lidhur me par.2 dhe 1 dhe nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, si vepër penale bazë e më pas kinse është kryer vepra penale nga i pandehuri Xhemajl Arifi “shpëlarja e parave” nga neni 32 sipas Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit lidhur me nenin 31 dhe nenin 81 të KPRK-së. Edhe pse gjykata nuk ka evituar shkeljet e bëra më parë sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit për të vërtetuar se a kemi të bëjmë me mashtrim apo jo dhe cili është mashtrimi.

Mbrojtësi më tutje potencon edhe shkelje nga neni 384 par.1, nënpar.1.3 të KPP-së ngase në shqyrtime gjyqësore nuk janë ftuar të dëmtuarit madje palët e dëmtuara si palë në procedurë nuk janë ftuar të gjithë. Edhe fakti se aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme, pra në supozimin se e dënuara Estrida Bunjaku ka kryer veprën penale të mashtrimit dhe se i dënuari Xhemajl Arifi e ka ditur se paratë e përfituara janë nga veprimtaria kriminale dhe e ka ndihmuar në fshehjen e gjurmëve të pasurisë edhe pse nga gjykata është anashkaluar fakti se vet Estrida ka deklaruar se kishte marrë hua 400.000,00 €, nga i dënuari Xhemajl Arifi, ku më pas i kishte kthyer 50.000 € dhe se i kishte mbetur borxh pjesën tjetër, çka vërtetohet edhe me deklaratimet e pronarëve të tokave të cilët kishin deklaruar se Xhemajli i kishte lutur ata që ta vazhdonin kontratën me Estridën dhe të përfundonin projektin e me qëllim që ai ta realizonte pjesën e tij të pagesës të cilën e kishte bërë me një marrëveshje ku ato para që ishin dhënë në emër të borxhin të llogariteshin si investim dhe të merrte sipërfaqe në ndërtesa për atë shumë parash.

Sa i përket shkeljes së Ligjit Penal mbrojtësi konsideron se ka shkelje të nenit 385 par.1, nënpar.1.1 të KPP-së, sepse nuk është vërtetuar se në veprimet e të dënuarit janë formuar elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor. Po ashtu, mbrojtja konsideron se ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes së veprës penale ngase dispozita e nenit 261 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës ku parashihet vepra penale mashtrimi, është paraparë dënim me burgim prej 6 muajve deri në 5 vjet, ndërsa neni 91 i të njëjtit ligj, parasheh se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, nëse e marrim se vepra penale shpëlarja e parave sipas prokurorisë është kryer deri më datën 16 janar 2012, ndërsa vepra penale mashtrimi është kryer shumë më herët, atëherë rrjedhimisht me vet parashkrimin e veprës penale mashtrimi nuk mund të ekzistojë as vepra penale

shpërlarja e parave. Sa i përket rikualifikimit të veprës penale në vepër penale të vazhdueshme, gjykata ka cituar dhe ka interpretuar gabimisht nenin 7 të Udhëzuesit të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut të datës 30 prill 2017 ku në fund të këtij citati, i cili nuk është cituar në tërësi thuhet “Gjykata ka verifikuar gjithashtu se masa e dënimit që i ishte dhënë të interesuarit mbi bazën e veprës penale të vazhduar, nuk ishte më e rëndë se sa ajo që do t’i ishte dhënë atij në qoftë se aktet e kryera prej tij përpara formës legjislative do të ishin vlerësuar në mënyrë të veçuar nga ato të kryera pas asaj. Anasjelltas në qoftë se dënimi për vepër penale të vazhdueshme nuk ka qenë i parashikueshëm në vështrim të së drejtës kombëtare të zbatueshme në kohën përkatëse dhe ai ka sjellë si pasojë rëndimin e masës së dënimit që i është dhënë të interesuarit, atëherë gjykata del me konkluzion se ka pasur një zbatim prapa veprues të Ligjit Penal në dëm të këtij të fundit (Veeber K.Estonisë dhe Puhk. K. Estonisë).

Pra, edhe Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës ka rregulluar këtë çështje me nenin 2 ku në mënyrë eksplicite parashihet se ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, andaj ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm, e të cilat dispozita janë të njëjta edhe me Kodin Penal të vitit 2013 dhe 2018.

Mbrojtësi i të pandehurit Valon Orlani, av. Ramiz Krasniqi nga P., pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje konsistojnë në faktin se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, ka kundërthënë të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetim e lidhur me përmbajtjen e shkresave të çështjes ku si pasojë aktgjykimi i tij nuk është përpiluar konform dispozitave të nenit 369 të KPP-së, të cilat shkelje Gjykata e Apelit nuk i trajton. Mbrojtësi pretendon se këto paqartësi dhe kundërthënie kanë të bëjnë jo vetëm me veprimet e përbashkëta të akuzuarve prej nga do të rezultonin elementet qenësore të veprës penale (shpërlarja e parave) për çka janë shpallur fajtorë dhe dënuar të akuzuarit, e që Gjykata e Apelit konsideron se nuk kemi të bëjmë me kundërthënie. Kështu, nga dispozitivi i aktgjykimit nuk rezulton se si janë marrë vesh të akuzuarit për të vepruar bashkërisht, cilat ishin detyrat e secilit, apo çka kishte kontribuar Valon Orlani në këtë vepër penale. Për më tepër, asnjëra nga gjykatat nuk jep arsye lidhur me faktin se si janë bashkezekutorë të pandehurit dhe ku qëndrojnë

elementet e veprës penale. Për më tepër kolegji i Gjykatës së Apelit pothuajse me përbërje të njëjtë, në rastin e njëjtë, jo vetëm që nuk i përfillë vërejtjet e dhëna me aktgjykimin e mëparshëm, por del edhe në kundërshtim të plotë me këto vërejtje duke konstatuar tani se nuk ka asnjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale edhe pse aktgjykimet e shkallës së parë kanë autorët e njëjtë dhe këto aktgjykime janë pothuajse identike.

Sa i përket shkeljet të ligjit penal, mbrojtja konsideron se gjykata në rishqyrtim nuk ka sqaruar dilemat se ku qëndrojnë veprimet e të dënuarit Valon Orllani dhe cilat nga karakteristikat e veprës penale shpëlarja e parave janë përmbushur në këto veprime, kur kemi parasysh se i dënuari ka pranuar 16.000 €, nëpërmjet W. U. dhe ku qëndron pastrimi i parave nga i njëjti. Ndërsa sa i përket çështjes së truallit në fshatin Ll. në sipërfaqe prej 5 ari, i njëjti nuk është në lagjen “...” por është në fshatin Ll., është blerë nga N. K. e jo nga B. G. dhe kontrata është lidhur dhe paguar nga Valon Orllani. Për më tepër, si mundet të vendoset që Valon Orllani t’i kompensojë solidarisht të dëmtuarit në lartësinë e pagesave të bëra të dëmtuarve kur asnjë i dëmtuar as nuk e përmend emrin e tij dhe asnjë nga ta nuk thotë se i ka paguar para nga banesat e blera nga Estrida Bunjaku.

Në kërkesë i pandehuri Xhemajl Arifi të paraqitur nga ai vet pretendon se, aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje qëndrojnë në faktin se në pikën 2 të dispozitivit konstatohet “duke tentuar t’i konvertoj” ndërsa në cilësim juridik thuhet se kanë kryer dhe këto kontradikta e bëjnë të pa qartë aktgjykimin, sepse nuk dihet se a është kryer vepra penale apo është tentuar. Po ashtu, me asnjë fjali nuk është arsyetuar ku qëndron bashkëkryerja, pra elementi subjektiv se ata janë marrë vesh dhe elementi i dytë se ata kanë marrë pjesë në veprimin e kryerjes apo thellësisht kanë kontribuar në shkaktimin e pasojës. Gjykata ka parafrazuar nenin 32 par.2, nënpar.2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, por me asnjë fjali nuk ka dhënë arsye se për cilën nga këto forma alternative që Ligji parasheh bëhet fjali. Po ashtu, në arsyetim nuk ka asnjë fjali se kur e dënuara Estrida na ka dhënë shumën e parave prej 1.872,719 €, kujt ia ka dhënë dhe kush sa ka marrë nga totali i këtyre parave. Po ashtu, gjykata anashkalon faktin se me një autorizim nga e njëjta, unë kam ndërtuar dhe përfunduar objektin me pëlqim urbanistik

e që nuk është kontestuese si dhe faktin se e dënuara Estrida kishte deklaruar se kishte marrë nga unë shumën prej 350.000,00 ose 400.000,00 €.

Sa i përket shkeljes së ligjit penal, i pandehuri Xhemajl Arifi konsideron se në veprimet e tij nuk ka elemente të veprës penale për të cilën është shpall fajtor por ka një raport të pastër civilo-juridik.

b). Vlerësimi i Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, gjen se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje të ligjit penal në dëm të pandehurve e të cilat shkelje do të përshkruhen më poshtë.

Fillimisht duhet të theksohet se Prokuroria Speciale e Kosovës, kishte ngritur aktakuzë PPS.nr.04/20215 të datës 12.05.2016, kundër të akuzuarve: Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku dhe Burim Vokrri, për shkak të veprës penale krimi i organizuar nga neni 274 par.1 lidhur me par.2 në raport me Estrida Bunjaku, par.3 të KPK-së, lidhur me veprën penale mashtrimi nga neni 261 par.1 lidhur me par.2 të KPK-së, si dhe kundër të pandehurve: Estrida Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokrri, Valon Orllani dhe Faton Orllani, për shkak të veprës penale shpërlarja e parave nga neni 32 par.2 pika 2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit lidhur me nenin 31 të KPK-së. Ndaj të pandehurës Estrida Bunjaku edhe për veprën penale shkaktimi i falimentimit nga neni 234 të KPK-së, dhe shmangie nga tatimi nga neni 249 par.1 lidhur me par.2 të KPK-së.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.06/2019 të datës 15.06.2022, të pandehurit: Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku dhe Burim Vokrri, janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale krimi i organizuar nga neni 283 par.1, lidhur në raport me Estrida Bunjaku, par.2 të KPRK-së lidhur me veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.5 e lidhur me par.1 dhe 2 të KPRK-së. Të pandehurit: Estrida Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokrri, Valon Orllani, janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale shpërlarja e parave nga neni 32 par.2 pika 2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit lidhur me

nenin 31 të KPRK-së, ndërsa i pandehuri Faton Orllani është liruar nga akuza. E pandehura Estrida Bunjaku, është liruar nga akuza për shkak të veprës penale shkaktimi i falimentimit nga neni 234 të KPK-së dhe shmangie nga tatimi nga neni 249 par.1 lidhur me par.2 të KPK.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.41/2022 e datës 24.03.2023, duke vepruar sipas ankesave të palëve, ka anuluar aktgjykimin sa i përket pjesës dënuese dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim ndërsa në pjesën liruese e ka refuzuar akuzën për shkak të parashkrimit.

Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim të pandehurit: Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku dhe Burim Vokri janë shpallur fajtorë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.2 dhe par.1 dhe me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, si dhe të pandehurit: Estrida Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokri dhe Valon Orllani, janë shpallur fajtor për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale shpëlarja e parave nga neni 32 par.2, nënpar.2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së. Pra, gjykata e shkallës së parë, ka bërë ri kualifikimin juridik të veprës penale, fillimisht duke e eliminuar krimin e organizuar si dhe duke gjetur se vepra penale e mashtrimit nga neni 335 (sipas Kodit Penal të vitit 2012) është kryer në vazhdim (neni 81 të KPRK-së) si dhe duke gjetur se vepra penale shpëlarja e parave nga neni 32 par.2, nënpar.2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit e lidhur me nenin 31 është kryer në vazhdim (neni 81 të KPRK).

Gjykata Supreme ka vlerësuar aktgjykimet e dy instancave në raport me pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe ka gjetur se të gjitha kërkesat po thuajse kanë pretendime të ngjashme lidhur me shkeljet e ligjit penal dhe vlerëson se me të drejtë pretendojnë mbrojtësit e të pandehurve se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje procedurale esenciale dhe me shkelje të Ligjit Penale, për arsye si në vijim:

Nuk është kontestuese se e pandehura Estrida Bunjaku, ka themeluar kompaninë "V. O G." në vitin 2010, e me qëllim primar ndërtimi i objekteve banesore. E njëjta, për këtë qëllim ka marrë zyrën dhe ka punësuar të pandehurin Burim Vokri, të cilin e ka

njohur që nga koha kur ka punuar në R. B.dhe i cili ka marrë pozitën zyrtar i shitjes deri në vitin 2012. Pagesa e pagës për të është bërë nëpërmjet llogarisë së bankës si dhe me kohë është punësuar dhe i pandehuri Vigan Bunjaku (vëllai i të pandehurës Estrida). Po ashtu, nuk është kontestuese se e pandehura Estrida për të realizuar planin e saj – ndërtimin e një kompleksi banesor kishte kontaktuar me pronarët e tokave në lagjen “...” dhe atë me 12 pronarë dhe me ta kishte një kontratë mbi ndërtimin e përbashkët ku ajo ka hyrë me 71%, ndërsa pronarët e tokave me 29%. Kjo kontratë është vërtetuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe pas nënshkrimit e njëjta ka bërë kërkesë në Komunën e Prishtinës për kushtet urbanistike për çka edhe ka marrë përgjigje se është i lejuar ndërtimi i lartë. Pas kësaj është dërguar projekti ideor dhe nga Drejtorati Komunal i Urbanizmit është aprovuar leje urbanistike që ka të bëjë me kushte ndërtimore. Për të filluar ndërtimin e pandehura Estrida kishte lidhur marrëveshje me kompaninë “V. A.” të cilët edhe kanë filluar punimet dhe është bërë ndërtimi i vrazhdë deri në katin e V-të në ndërtesën A1, ndërsa kanë vazhduar edhe punimet në rrëmihje për objektin e dytë dhe se me këtë rast është zbuluar se në atë vend është një gyp i Kompanisë K.. “P.” dhe është pamundësuar vazhdimi i punës. Po ashtu, është fakti i pakontestueshëm se K. “P.” fillimisht ka dhënë pëlqim për kushtet teknike të pjeshëm me arsyetimin se në lokacionin në fjalë shtrihet gypi furnizues magjstral ... mm., i ujit dhe se ndërtesat A2 dhe 3 nuk mund të ndërtohen. Më tutje, në procedurën administrative të shqyrtimit dhe vendosjes së kërkesës për leje ndërtimore, ka dhënë kushte teknike për ndërtimin e ndërtesave A3 dhe A4 bazuar në lejen urbanistike e cila ishte siguruar nga investitorët të cilët e kanë vazhduar ndërtimin pasi që e pandehura Estrida i kishte shkëputur marrëveshjen me pronarët e tokave. Gjithashtu, qëndron fakti se e pandehura Estrida kishte filluar shitjen e banesave në kompleksin në lagjen ... dhe se me këtë rast kishte lidhur para kontrata me një numër të madh të personave të cilit kishin paguar shuma të ndryshme të parave duke filluar prej 5000 € e më lartë e në emër të paradhënies. Të gjitha këto fakte janë vërtetuar drejtë nga dy gjykatat e instancave më të ulëta e gjithashtu është vërtetuar edhe fakti se e pandehura Estrida pas marrjes së kushteve urbanistike kishte aplikuar edhe për leje për ndërtimin e banesave dhe kishte marrë përgjigjen ku ishte përcaktuar edhe shuma prej 246,204.84 € si kompensim për rregullimin e tokës ndërtimore e cila shumë në qoftë se nuk do të paguhej brenda afateve të caktuara do të pasojë pezullimi i procedurës për lëshimin e lejes ndërtimore në bazë të së cilës edhe është llogaritur kompensimi. Meqenëse e pandehura kishte filluar ndërtimin e objekteve bazuar në kushtet urbanistike (sepse në

atë kohë kjo ishte e mundur bazuar në rregullativën ligjore), kishte filluar edhe shitjen e banesave. Në pamundësi të pagesës së shumës së përcaktuar nga Drejtoria e Urbanizmit, kishte filluar edhe stagnimi i punimeve e për më tepër është paraqitur edhe problemi i gypit për të cilin janë kërkuar 200.000,00 € për largimin e të njëjtit dhe në këto momente firma "V. O G." është bllokuar. Pronarët e tokave me të vërejtur se është ndërprerë puna, kanë kërkuar nga e pandehura që të vazhdojë punën apo t'i tregojnë arsyet e mos vazhdimit të punimeve. Përkundër të gjitha kërkesave e pandehura në pamundësi financiare është detyruar që me pronarët e tokave të shkëputë kontratën e cila është vërtetuar në gjykatë dhe t'ia bartë të gjitha autorizimet të pandehurit Xhemajl Arifi, i cili është autorizuar të ndërmerre veprime të nevojshme me pronarët e tokave ndërsa e pandehura Estrida ka marrë të gjitha obligimet e krijuara ndaj personave të tretë (blerësve të banesave apo lokaleve, punë kryesve etj.) ndërsa pronarët e tokave janë pajtuar që të bëjnë shkëputjen formale të kontratës për ndërtimin e përbashkët e po ashtu janë pajtuar që investimi i bërë në paluajtshmëritë e pronave t'i kompensohet investitores (Estridës) sipas vlerësimit i cili do të bëhet nga një grup ekspertësh profesional nga lëmi i ndërtimtarisë. Me të njëjtën marrëveshje pronarët e tokave janë pajtuar që ky investim i vlerësuar do të kompensohet në para apo në ndërtim me investitorin e ardhshëm për vazhdimin e projektit të aprovuar nga Drejtoria Komunale për Urbanizëm. Po ashtu, është vërtetuar se i pandehuri Xhemajl Arifi në cilësinë e investitorit tashmë, ka lidhur kontratë me pronarët e tokave të cilët janë pajtuar që të vazhdojnë ndërtimin e objekteve dhe kanë lidhur kontratë me kompaninë "A. G." SH.A për vazhdimin e ndërtimit të objekteve për të cilat tashmë kanë ekzistuar- lejet përkatëse, ndërsa me të njëjtën kontratë e cila është vërtetuar në gjykatë, është përcaktuar se i pandehuri Xhemajl Arifi, i cili tashmë kishte autorizim nga Estrida Bunjaku, ku të gjitha obligimet e dala nga kontrata paraprake bien mbi investitorin "V. O G.", ndërsa investimi i bërë i deri tashëm mbetet në pronësi të Xhemajl Arifit. Po ashtu, kjo gjykatë gjen se të gjitha këto janë marrëdhënie civilo-juridike të cilat dalin nga kontratat e lidhura në mes të palëve kontraktuese. Ndërsa, nga provat të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor gjen se gabimisht të dy gjykatat e kanë vlerësuar faktin se i pandehuri Xhemajl Arifi ia kishte dhënë hua të pandehurës Estrida shumë prej 400.000,00 € nga të cilat e njëjta i kishte kthyer 50.000,00 €, ndërsa për pjesën tjetër të parave ekziston marrëveshja për kompensim me sipërfaqe banimi prej 1000 m² në objektin i cili ishte ndërtuar nga e pandehura Estrida. Kjo duke u nisur se në shkresa përveç deklaramit të pandehurës Estrida dhe të pandehurit Burim Vokri, i cili

në deklaratën e tij konfirmon se ka qenë prezent kur është bërë dorëzimi i parave, gjendet edhe deklarata e vërtetuar në gjykatë me datën 8.9.2009 sipas numrit Vr.nr. ... ku e njëjta deklaroi se nga i pandehuri Xhemajl ka pranuar mjete financiare në shumë prej 350.000,00 € për fillimin e ndërtimit të objekteve banesore dhe se afati i kthimit ka qenë me datën 30.10.2009, e në rast të moskthimit të këtyre mjeteve e njëjta është pajtuar që të pandehurin Xhemajl Arifi t'ia kompensojë me hapësirë banesore prej 1000 m² në hapësirat banesore Gjykata e shkallës së parë në arsyetim gabimisht konstaton se deklarata e vërtetuar dhe e vulosur në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë, me numër Vr.nr.7408/09 datë 8.9.2009 ngase nuk kishte kontratë të vërtetuar në gjykatë dhe se deklaratat e të pandehurve ishin kontradiktore e po ashtu konstaton se kjo dëshmi nuk është vulosur në gjykatë e që bie ndesh me provat materiale të cilat gjenden në shkresa të lëndës.

Nga shkresat po ashtu, vërtetohet se e pandehura ka tentuar që të vazhdojë ndërtimin duke lidhur kontratë me pronarë tjerë të tokave dhe atë N. S. A. dhe R. H. A., me të njëjtat kushte sikur edhe me pronarët tjerë, e cila kontratë është lidhur dhe vërtetuar në gjykatë me datën 19.04.2012. Lokacioni ishte në lagjen M. dhe e pandehura kishte filluar ndërtimin e objekteve banesore, por punimet ishin ndërpre pasi që Inspektorati Komunal kishte konstatuar se lidhur me këto parcela kishte kontest gjyqësor dhe se deri në vendosje punët duhet të ndërpriten.

Gjykatë fillimisht vlerësoi kërkesat e mbrojtësve të pandehurve Estrida Bunjaku, Vigan Bunjaku dhe Burim Vokri sa i përket veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par.2, nenin 31 dhe 81 të KPRK-së dhe konstatoi se në veprimet e tyre nuk formohen elementet e veprës penale për të cilën janë, shpallur fajtorë për arsye si në vijim:

Çka është vepra penale e mashtrimit si vepër penale kundër pasurisë?

Mashtrimi është një vepër penale e orientuar kundër pasurisë (së luajtshme dhe të paluajtshme), duke përfshirë edhe të drejtat dhe interesat pasurore. Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale qëndron në paraqitjen **e rrejshme të fakteve a duke i fshehur faktet.**

Me paraqitjen e rrejshme të fakteve nënkuptohet pohimi për ekzistimin e ndonjë fakti që nuk ekziston, përkatësisht paraqitja e fakteve ndryshe nga ajo që vërtet ekziston, (ajo që ekziston tregohet jo saktësisht). Fshehja e fakteve ekziston kur kryerësi ndonjë person e mashtron për mosekzistimin e fakteve ekzistuese apo e hesht ekzistimin e tyre, përkatësisht përmbajtjen e tyre, nëse ka ekzistuar detyrimi i tij që ato fakte t'i tregonte. Ndërkaq, te tregimi i rrejshëm, kryerësi e bind ndonjë person për ekzistimin e ndonjë fakti që nuk ekziston, d.m.th., te fshehja ai pengon personin që t'i mësojë faktet që vërtet ekzistojnë e të cilat janë relevante për pasjen në dispozicion të pasurisë së tij dhe pasurisë së huaj dhe të cilat do ta zmbropsin nga pasojat e dëmshme në raport me këtë pasuri.

Si prokurori në aktakuzën e tij, sikundër gjykata që e ka gjykuar çështjen, formalisht përdorin shprehjet e Kodit Penal për mashtrimin, citojmë “ **me paraqitje të rrejshme apo duke i fshehur faktet** “por nuk e japin asnjë arsye se cilat fakte i paska fsheh e dënuara Estrida Bunjaku dhe në çfarë dimension qenka prezantuar rrejshëm, ngase ligji i parasheh dy alternative të mundshme të mashtrimet, si prokuroria në aktakuzë sikundër gjykata që e ka gjykuar çështjen, nuk japin asnjë shpjegim në këtë drejtim, ngase nuk ekziston as fshehja e as prezantimi i rrejshëm, e pa këto rrethana kjo vepër penal nuk mund të ekzistoj.

E dënuara, me të gjithë blerësit e interesuar, kishte lidhur para kontrata në përputhje me ligjin, ashtu siç funksionon tregu i ndërtimit, në para kontratat u përcaktuan detyrimet e kontraktuesve dhe dinamika e përmbushjes së detyrimeve reciproke, pastaj pasojat e mos përmbushjes së kontratës, asgjë nuk ka fshehë, por nuk i ka kryer-përmbushur obligimet kontaktuese ndaj blerësve, e njëjta gjë hipotetikusht ka mund t'u ndodhë palës tjetër kontraktuese - blerësve, që të vendosen në apartamente dhe mos t'i përmbushin detyrimet nga kontrata, ngase janë rënë vështirësi financiare.

E dënuara kishte biznesin e saj legalisht të regjistruar, që atë e legjitimonte të merret më ndërtime dhe kështu kishte vepruar, sigurisht ka kalkuluar se është në gjendjet që t'i përmbush detyrimet kontraktuale dhe ka hyrë në aranzhime të tilla, më shumë blerës të interesuar për banesa, mirëpo gjatë procesit të punës së saj, nuk i kanë shkuar punët ashtu si ajo ka llogaritur dhe nuk ka mundur t'i përmbush obligimet kontraktuale ndaj blerëseve me të cilit kishte lidhur para kontrata, e që s'do mend se

mos përmbushja e obligimeve kontraktuale është veprim i paligjshëm, por jo vepër penale, pa ekzistuar qëllimi mashtrues i të dënuarës, e që në rastin konkret, nuk ka asnjë provë që e argumenton një veprim të tillë dhe prova të tilla nuk janë prezantuar dhe arsyetuar në këtë aktgjykim.

Qëllimi i mashtrimit është **përfitimi i dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme**. E dënuara lidhi para kontratë me të gjithë blerësit e interesuar në përputhje me çmimin e tregut që ishte atë kohë, te vepra penale e mashtrimit, kryesi i veprës penale paraprakisht shpreh qëllimin mashtrues (*prezantohet rrejshëm apo i fshehtë faktet*), u sqarua më sipër asnjëri nga elemente e mashtrimit nuk ishin të pranishëm në veprimet e të dënuarës. Po mos të ishte e dënuara e bindur se është në gjendje t'i përmbush detyrimet, në asnjë mënyrë nuk do futej në rreziqe të tilla, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se ajo, **jo që ka përfituar materialisht**, e që përfitimi i kundërligjshëm është element primar i kësaj vepre penale, por përpos që ka dëmtuar kontraktuesit -blerësit e interesuar (*nuk ua ka përfunduar apartamentet sipas kontratës*) e dënuara ka bankrotuar edhe vet veten dhe familjen e saj, ngase për t'ua kthyer borxhet kontraktuesve ka shitur edhe shtëpinë e babi të saj duke i lënë në rrugën familjen e saj dhe duke u futur në borxhe të mëdha tek personat tjerë.

Do mund të thuhet se bëhet fjalë për mashtrim duke u prezantuar rrejshëm, sikurse në rastin konkret e dënuara Estrida Bunjaku, blerësve-dhënëseve të tokës për ndërtim, t'iu thoshte se posedon ndërmarrje ndërtimore e që realisht nuk e kishte, apo se ka blerë toka për ndërtimin e banesave, pa i blerë fare, mirëpo në rastin konkret nuk kishin një situatë të tillë, ajo kishte biznesin e saj për ndërtim, kishte blerë toka për ndërtim dhe në të gjitha objektet që i kishte filluar me i ndërtuar kishte pëlqim urbanistik.

Është fare e qartë, se në rastin konkret, bëhet fjalë për raport të pastër civilo-juridik, e jo për vepre penale të mashtrimit, siç pretendon prokurori me aktakuzë dhe siç kanë gjetur dy gjykatat instancionale, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se biznesit të të dënuarës nuk i kanë shkuar punët mbarë, sipas parashikimeve dhe dinamikës së planifikuara, për pengesa të ndryshme, duke përfshirë edhe ato administrative komunale dhe zvarritje e tilla e kanë falimentuar biznesin e saj. Nuk konsiderohet vepër penale çdo mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale, për faktin se, kontestet e tilla mbrohet me ligjet tjera civile e jo me KP.

Nëse e shihet kronologjia e ndërtimit të akti akuzues, rezulton se çështje penale ndahet në dy periudha të ndryshme kohore, me vepra penale të ndryshme edhe atë: Periudha kur tani e dënuara Estrida Bunjaku, si pronare e kompanisë “V. O G.” me disa kontaktues kishte lidhur para kontrata për blerjen e banesave, me disa të tjerë kontratë për bashkimin e punës dhe mjeteve, e që të gjitha para vitit 2013, ku ka filluar të aplikohet Ligji i vitit 2012, e që nga prokuroria dhe dy gjykatat po konsiderohet si veprë **penale e mashtrimit** dhe periudhën e dytë, kur kjo e dënuar ka kontraktuar nënkontraktues të ndryshëm, për punë të ndryshme, për përfundimet e objekteve që ajo kishte detyrim t'i ndërtonte, e të cilat veprime nga prokurori dhe dy gjykatat instancionale po konsiderohen, për të dënuarën Estrida Bunjaku dhe të dënuarit e tjerë **shpëlarje e parasë** .

Edhe sikur të ekzistonte vepra penale e mashtrimit, u sqarua më sipër se bëhet për raport të pastër civile- juridike, çështja rezulton e parashkruar për këto arsye:

Nga përshkrimi faktik i veprës penale në dispozitivin 1.të aktgjykimit, rezulton se të gjitha para kontratat me të dëmtuarit, për të cilat prokuroria ka pretenduar se janë **lidhur me mashtrim** dhe këtë pretendim të prokurorisë e kanë pranuar edhe dy gjykatat instancionale, janë kryer në periudhën 2009 -2012, kur në fuqi ishte KP i viti 2004. Ky kod, veprën penale të mashtrimit e parashihte në nenin 261 i cili kishte dy paragrafë, paragrafi 2 ishte cilësues, për shkak të vlerës së dëmit mbi 15,000 € dhe parashihte dënim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vite. Në nenin 90 par.1, nënpar.1.5 të KPK, parashihej që afati relativ i parashkrimit për vepra penale të dënueshme deri në pesë (5) vjet është pesë (5) vite, ndërsa në nenin 92 .par.6 theksohej se ndjekja penale ndalohet nëse ka kaluar dyfishi i kohës së paraparë.

Nga viti 2009-2012 e deri më datë 24.08.2024, kur aktgjykimi ka marr formën e prerë, kanë kaluar mbi 10 deri në 15 vite, ndërsa për veprën penale nga neni 261 par.2 të KPK, që ishte në fuqi kur janë lidhë para kontratat, afati absolut është 10 vite .d.m.th. në kohën e gjykimit këto vepra penale ishin të parashkruar.

Në shqyrtim gjyqësor prokurori e ri cilësoi veprën penale sipas KPK të viti 2012, për ta shmangë parashkrimin e veprës penale të mashtrimit, dhe me këtë cilësim të

paligjshëm, u pajtuan edhe dy gjykatat instancionale, ngase lidhur me veprën penale të mashtrimit edhe po të ekzistonte, në asnjë mënyrë nuk ka mundur të zbatohet ligji i vitit 2012, siç gabimisht ka vepruar gjykata e shkallës së parë, ngase me këtë ka cenuar një parim fundamental në të drejtën penale, se ndaj kryesit të veprës penale aplikohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, ndërsa ligji i më vonshëm vetëm nëse është ma i favorshëm për të pandehurin, e që në rastin konkret nuk kemi një situatë të tillë, ngase neni 335 i KPK të vitit 2012 (që ka hyrë në fuqi nga 01.01.2013), të cilin e ka aplikuar Gjykata ndaj të dënuarve është dukshëm më i ashpër se neni 261 i KPK që ishte në fuqi në kohën kur pretendohet se ishin kryer të gjitha veprat penale të mashtrimit, për faktin se përmban edhe 4 paragrafë që Kodi në fuqi nuk i kishte dhe të gjithë paragrafët janë dukshëm më të ashpër se ato dy paragrafë nga neni 261 i KPK të vitit 2004.

Shpëlarja e parasë

Në rastin konkret, vepra penale e shpëlarjes së parave, organikisht është e lidhur me veprën penale të mashtrim, për të cilën u sqaruar më sipër se nuk ekziston, por edhe sikur të ekzistonte është parashkruar, Gjykata Supreme e sheh të nevojshme që edhe këtë dimension ta sqaroj. Të dënuarit Xhemajl Arifi i vihet në ngarkesë vepra penale e shpëlarjes së parasë, fakti se ai është autorizuar nga e dënuara Estrida Bunjaku që të vazhdoj me ndërtimin e objektit të cilën ajo tanimë e kishte filluar por kishte ngecur për shkak të vështirësive financiare dhe borxhit që e dënuara Estrida ia kishte Xhemajlit, të dënuarit Burim Vokri i vihet në ngarkesë vepra penale e shpëlarjes së parasë, fakti se ai kishte marrë një automjet ..., një dhomë të fjetjes, shpenzime për dasmë, shpenzime verore e shpenzime të tjera, të dënuarit Valon Orllani si shpëlarje të parasë, i vihet nga ngarkesë fakti se: gjatë viti 2009, në xhirollogarinë personale ka pranuar 16.000 €, në vitin 2010, nga A. B., ka pranuar 14.600 € në emër të pagesës për banesën e blerë, nga Estrida Bunjaku ka pranuar një xhipin "... në vlerë prej 35.300 € dhe ka blerë një truall në fshatin Ll., në sipërfaqen prej ... ari. Asnjë nga veprimet e përshkruara më sipër nuk përmbajnë asnjë element të veprës penale të shpëlarjes së parasë, po janë raporte kontraktuale në mes të palëve.

Nga shkresat e lëndës përtej çdo dyshimi rezulton se i dënuari Xhemajl Arifi, nuk ka marr para nga Estrida Bunjaku për t'i mundësuar asaj shpëlarjen, siç gabimisht është

konstatuar në aktgjykimin e atakuar, por përkundrazi, meqenëse ajo ndodhjen në vështirësi financiare, i dënuar Xhemajl, i ka dhënë 4000.000 € hua, ky fakt i provuar me prova të pakontestueshme, pretendimet e prokurorit dhe gjetjet e gjykatës se i dënuari Arifi, paska marr para nga e dënuara Estrida Bunjaku etj., për t'i ndihmua shpëlarjen e parave, që ajo i kishte përfituar me veprime kriminale-me mashtrim, janë konstatime me hamendësime dhe të pambështetura në asnjë provë, në çka me të drejtë tërheq vërejtjen mbrojtësi në kërkesën e tij edhe sikur t'i kishte marr nga Estrida Bunjaku “shumën e pacaktuar të parave” i dënuari Xhemajl, nuk do konsiderohej ndihmë në shpëlarje të parasë, ngase i ka investuar në objektin ku ajo kishte pëlqim urbanistik për ndërtim po edhe detyrim karshi kontraktuesve-blerësve, **edhe veprimet e dy** dënuarve të tjerë; Burim Vokri dhe Valon Orlani, nuk kanë të bëjnë fare me këtë veprë penale. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar, se të pandehurit, duke e ditur se e pandehura Estrida parat i ka përfituar me vepër penale, bashkërisht i kanë ndihmuar që t'i shpërlaj ato, pa dhen asnjë arsye të vetme se ku i mbështetë përfundimet e tilla, se ata e paskan ditur dhe pa dhënë asnjë të vetmin sqarim se si paskan bashkëvepruar, kur qenkan marrë veshë, ku, si, gjithashtu gjykata nuk ka dhënë asnjë arsye të vetme se: **kur, ku dhe** sa para, ka dhënë e dënuara Estrida Bunjaku, secilit nga të dënuarit për t'ia shpërlarë ato para.

Aktgjykimi është i paqartë edhe sa i përket cilësimit juridik, ngase të dënuarit: Estrida Bunjaku, Xhemajl Arifi, Burim Vokri dhe Valon Orlani, që të gjithë janë shpallë fajtorë për veprën penale të shpërlarjes së parasë, të parashikuar nga neni 32 par.2, nënpar.2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 të Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPK, për faktin se secilit të dënuar i vihen në ngarkesë veprime të ndryshme, e që nga gjykata po konsiderohet shpërlarje e parasë, ndërsa veprimet e të gjithëve cilësohen me paragraf dhe nën paragrafë të njëjtë (2.1,2.2, 2.5, 2.6), ndërsa neni 32 ka gjithsejtë tetë (8) nën paragraf që rregullojnë dhe sanksionojnë situata të ndryshme, nuk është e mundur që veprime e ndryshme të të dënuarve të vihen nën normën e njëjtë penale juridike .

Me të drejtë me kërkesën e të pandehurit Xhemajl Arifit dhe të tjerëve pretendohet se Gjykata e Apelit me ankesat e para i pranoj ankesat dhe anuloj aktgjykimin e ankimuar PKR.nr.06/2019 datë 15.06.2022, me konstatimi se është i përfshirë me shkelje procedurale, ligjore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë në rigjykim, vetëm ka rihap formalisht çështjen, por asgjë nuk ka ndryshuar,

asnjë veprim shtesë nuk ka marr dhe aktgjykimi i dytë është në tërësi i njëjtë me atë të parin, përpos me vendimin për dënimi, ku të pandehurve u është ulë dënimin. Aktgjykimi i dytë PKR.nr.60/2023 dt.17.11.2023, (me rastin e rigjykimit) i përmban po të njëjta shkelje që i përmbante aktgjykimi i parë, për të cilat Gjykata e Apelit e kishte anuluar, mbrojtësit e të pandehurve me rastin ankesave të dyta, ndaj këtij aktgjykimi kishin vënë në pah, po të njëjta shkelje që realisht ekzistonin, për çudi Gjykata e Apelit, i refuzon ankesën dhe vërteton aktgjykimin e dytë edhe pse u përshkruar më sipër ishte i njëjtë me atë të parin, pos me vendimin për dënimin, tani shfaqen dilema, se njëri vendim i gjykatës së Apelit rezulton i paligjshëm, aktgjykimi APS.nr41/2022 datë 24.03.2023, me të cilin ka anuluar aktgjykimin PKR.nr.06/2019 datë 15.06.2022, apo aktgjykimi APS.nr41/2022 datë 24.03.2023, me të cilin aktgjykimin e shkallës së parë PKR.nr.60/2023 datë 17.11.2023, e vërteton.

Gjykata meqë të dënuarit i liroi akuza, vendosi që trualli i konfiskuar nga i dënuari Valon Orllani, në fshatin Ll., t'i kthehet në pronësi pronarit, për faktin edhe sikur të mbetej aktgjykimi dënues nuk kishte as një bazë ligjore që t'i konfiskohej, ngase këtë truall ky i dënuar e kishte blerë nga personat tjerë, e që nuk kishin asnjë lidhshmëri me të dënuarën Estrida Bunjaku.

Meqenëse të dënuarit janë liruar nga akuza, gjykata ka vendosur që konform nenit 453 të KPPK shpenzimet e procedurës të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtarëve në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është i bazuar në nenin 462 par.3 i KPP-së.

Nga të gjitha këto që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitës së nenit 438 të KPP-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

PML.nr.682/2024, më 6 shkurt 2025

Numri i lëndës: 2020:156726
Datë: 21.03.2025
Numri i dokumentit: 07024698

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi